



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 246/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e NISMA për Kosovën, dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me dt. 09.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Nismes për Kosovën dega në Prishtinë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 08.06.2014, Nisma për Kosovën dega në Prishtinë me të cilën pretendohet se me datën 07.06.2014, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) është thyer heshtja zgjedhore duke paraqitur sloganin nëpërmjet rrjetit kompjuterik “youtube” gjatë kohës së heshtjes zgjedhore. Parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur dy fotografi si dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Nga fotografit e ofruara si prova të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk vërehet dhe nuk shihet qartë slogani i shfaqur në “youtube” dhe nuk mund të identifikohet koha se a është gjatë fushatës zgjedhore apo gjatë heshtjes zgjedhore, andaj një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu administruar si provë relevante, prandaj sipas nenit 3.6 pika b) Rregullave dhe Procedurave të PZAP-së, duke u bazuar edhe dispozitat e nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr.246/2014 më datën 09.06.2014

Kryesuesi i Panelit
Ymer Hoxha



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*